

VENDIM
Nr. 276, datë 27.10.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB ENERGY TRADE” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “f”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1829/10 prot., datë 24.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Alb Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1840 prot., datë 19.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gerrat “a”, “b” dhe “c”, për pikën 1.2, gerrat “a” dhe “d”, për pikën 1.3, germa “c” dhe për pikën 2.5, gerrat “a”, “b” dhe “c”.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni, si vijon:

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e penalitetit) për shoqërinë dhe administratorin e saj.

- Germa “c”: Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse mbi numrin e administratorëve të saj dhe të sjellë informacion nëse është miratuar versioni final i organigramës së saj.

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- Germa “a”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore.

- Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE letrën e interesit të lëshuar nga banka, ku të referohet financimi për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkon të licencohet, pra furnizimi me energji elektrike ose të depozitojë vërtetim bankar për disponimin e kapitalit fillestar dhe mundësinë e përdorimit të kësaj shume për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

- Pika 2.5, “Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike”:
- Germa “d”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion mbi nivelin e tensionit që do të furnizojë klientët.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti